

Rekomandime për drejtuesit e autobusëve gjatë krizës të COVID-19


1



Pastroni hapësirën e kabinës të shoferit,

duke përdorur dezinfektues, mundësisht disa herë në ditë. Përqendrohuni në mënyrë të veçantë në dorezat e dyerve të brendshme dhe të jashtme. Kur e pastroni kabinën e shoferit pastroni edhe timonin dhe ndërruesin e shpejtësive. Përqendrohuni për pastrim në hapësirën në mbajtëset individuale të kokës, në krahët e ulëseve të udhëtarëve si dhe në anësoret e ulëseve.

2



Ajroseni (ventiloni) rregullisht hapësirat ndarëse në mes të udhëtarëve

në pikat e ndalimit. Nëse temperatura lejon, drejtoni autobusin me dritare të hapura. Shmangni përdorimin e ajrit të kondicionuar ose ngrohjen.

3



Lani duart

me ujë dhe sapun të lëngshëm për 30 sekonda. Dezinfektoni duart rregullisht para hyrjes dhe pas daljes nga automjeti dhe pasi të keni kryer procedurat e kërkuara të pastrimit.

4



Vendosni dorëza

kur përdorni mjete elektronike biletash, kuona fiskal ose kur të merrni para të gatshme.

5



Qëndroni në kabinën e shoferit

sa herë që është e mundur përderisa jeni në detyrë, përveç nëse kërkohet ndryshe. Nëse duhet të komunikoni me udhëtarë, vendosni një maskë mbrojtëse dhe doreza.


6



Ruani një distancë të mirë nga udhëtarët kur komunikoni

brenda automjetit. Vendosni një maskë mbrojtëse dhe dorëza dhe dezinfektojini duart pas çdo kontakti të ngushtë.

7



Informoni udhëtarët për rëndësinë e mbajtjes të një distance prej 1 metër nga të tjerët.

Monitoroni pajtueshmërinë, veçanërisht kur identifikoni udhëtarët me simptoma të frymëmarrjes të vështirësuar.


8



Jeni të vetëdijsëm për përhapjen e virusit

përmes kollitjes dhe teshtitjes (përmes pikave të ajrit), si dhe përmes kontaktit të drejtpërdrejtë.

9



Nëse ju ose anëtarët e familjes tuaj shfaqni simptoma të mundshme të COVID-19, të tilla si një kollë e thatë ose ethe, njoftoni menjëherë menaxherin tuaj.

10



Ndiqui udhëzimet specifike nga kompania juaj dhe rekomandimet/udhëzimet e përgjithshme të lëshuara nga autoritetet shëndetësore.

Jeni të përgjegjshëm dhe përdorni sensin tuaj të përbashkët.

